



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 131, datë 3.3.2021

P Ë R

**PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN  
E RIKONSTRUKSIONIT OSE RIPARIMIT TË MJEDISEVE  
NË BASHKËPRONËSI OSE TË PËRBASHKËTA NË NDËRTESA  
(PALLAT), NË BASHKITË KAVAJË DHE MIRDITË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarja "i", 25 e 36, të aktit normativ nr.9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr.97/2019, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr.137/2020, "Për buxhetin e vitit 2021", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, në masën 400 081 860 (katërqind milionë e tetëdhjetë e një mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë) lekë, për financimin e rikonstruksionit ose riparimit të mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesa (pallat), në bashkitë Kavajë dhe Mirditë.
2. Efekti financiar, sipas pikës 1, të këtij vendimi, të përballohet nga shpenzimet e fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2021, dhe t'u kalojë bashkive Kavajë dhe Mirditë, në formën e transfertës së pakushtëzuar sipas detajimit të mëposhtëm:
  - a) Bashkisë Kavajë i transferohet fondi prej 349 125 000 (treqind e dyzet e nëntë milionë e njëqind e njëzet e pesë mijë) lekësh;
  - b) Bashkisë Mirditë i transferohet fondi prej 50 956 860 (pesëdhjetë milionë e nëntëqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë) lekësh.

3. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe bashkitë Kavajë e Mirditë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në "Fletoren zyrtare".

**KRYEMINISTRI**

**EDI RAMA**

**Në mungesë dhe me porosi**

**ZËVENDËSKRYEMINISTRI**

**ERION BRAÇE**

**MINISTRI I SHTETIT  
PËR RINDËRTIMIN**

**ARBEN AHMETAJ**